



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202001495/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** Rekomandim për krijimin e kushteve, për një mjedis të përshtatshëm edukimi.

**BASHKISË BERAT**

*Për dijeni:*

**SHKOLLËS 9-VJEÇARE "22 TETORI"**

**BERAT**

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, kreu një vizitë në shkollën 9-vjeçare publike "22 Tetori" në qytetin e Beratit. Një ndër ankesat e nxënësve të kësaj shkolle, ishte mungesa e sistemit të ngrohjes, duke detyruar nxënësit të rrinë në klasa të veshur dhe mungesa e shkallëve të emergjencës.

Autoritetet publike dhe jopublike kanë në konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës, në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët<sup>1</sup>. Ndaj, theksojmë, që mungesa e tyre përbën një standard minimal të munguar.

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet, për rastet e veçanta të bëra publike. Dhe, për këtë qëllim, në

<sup>1</sup> Pika 2, e nenit 6, të ligjit 18/217 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

zbatim të shkronjës “b”, të nenit 19, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin.

Në këtë frymë, institucioni i Avokatit të Popullit kreu hetimin administrativ, nëpërmjet komunikimit shkresor, me Zyrën Vendore Arsimore Berat dhe Bashkinë Berat. Për rastin në fjalë, rezultoi, se prej kohësh, shkak për mungesën e një sistemi ngrohjeje funksional të mjediseve të brendshme të shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” është gjendja e amortizuar e rrjetit elektrik. Gjithashtu, u konstatua edhe mungesa e shkallëve të emergjencës, aq të domosdoshme në rastet e evakuimit të menjëhershëm të fëmijëve dhe stafit pedagogjik.

Në funksion të zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, për t’i ofruar një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe në mbështetje të pikës 11, të nenit 23, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkitë janë përgjegjëse në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

Institucionet kanë detyrimin të sigurojnë, që fëmijët dhe të rinjtë të trajtohen si duhet në shkollë dhe të drejtat e tyre njerëzore të mos shkelen, kjo në qëllim të ofrimit të kushteve të përshtatshme për një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social të fëmijës<sup>2</sup>.

Për sa më sipër, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre dhe, në zbatim të legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës në përcaktimin e qartë të detyrave të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

---

<sup>2</sup> Në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë, e transpozuar kjo, edhe dhe në pikën 3, të nenit 6, të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

## **REKOMANDON:**

- Marrjen e masave, për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të ngrohjes dhe vendosjen e shkallëve të emergjencës në shkollës 9-vjeçare “22 Tetori”.

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

## **K O M I S I O N E R**

**Nejla PEKA**

